

Me qëllim përfshirjen e kandidatëve nga IAL-të publike dhe ato jopublike, ligjvënësi në nenin 51, pika 5 të Ligjit nr. 115/2016 parashikon procedurën e përzgjedhjes ku ndër të tjerash thuhet se *“Quhen të përzgjedhur 7 kandidatët nga IAL-et publike ose Shkolla e Magjistraturës dhe 3 kandidatët nga IAL-et jopublike që kanë marrë numrin më të madh të votave. ... Në qoftë se nuk ka kandidatë të mjaftueshëm nga IAL-et jopublike për të plotësuar kuotat e parashikuara në këtë pikë, vendet e mbetura bosh plotësohen nga kandidatët e IAL-ve publike”*. Sipas kësaj dispozite, për një vend vakant nga IAL-të dhe Shkolla e Magjistraturës kërkohen 10 kandidatë. Si në rastin e kandidatëve të përzgjedhur si anëtar të KLGJ-së dhe të KLP-së, rezulton se në përputhje dhe me nenin 36, pika 3 të Ligjit nr. 115/2016, secili prej institucioneve të arsimit të lartë përzgjedh jo më shumë se 3 kandidatë nga radhët e personelit akademik me kohë të plotë. **Nga përzgjedhja e realizuar, KShH vëren se kandidatët nga IAL jopublike nuk kanë qenë 3, dhe plotësimi i kuotave është realizuar me kandidatët e IAL-ve publike.**

Numri minimal i kandidatëve parashikuar në nenin 51, pika 5 nuk përputhet me atë të parashikuar në nenin 53, pika 1 të ligjit nr.115/2016, i cili parashikon se *“... i përcillen Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit në një listë me emrat e kandidatëve që kanë marrë pikët më të larta, por jo më shumë se 10 kandidatë dhe në çdo rast jo më pak se trefishi i numrit të vendeve vakante...”*. Sipas kësaj dispozite, për dy vende vakante në secilin prej Këshillave kërkohen të paktën 6 kandidatë (pra 3 për një vend vakant). Rrjedhimisht kemi mendimin se neni 51, pika 5 dhe neni 53, pika 1 e ligjit nr.115/2016 kanë nevojë të harmonizohen për të shmangur paqartësitë, subjektivizmin dhe zbatimin jo të njëtrajtshëm të ligjit.

Një nga të drejtat që ligjvënësi i ka njohur kandidatëve nga bota akademike për t'u bërë pjesë e Këshillave është e drejta e ankimit ndaj vendimarrjeve të mbledhjes së posaçme. Në media apo në faqet zyrtare të institucioneve nuk është pasqyruar asnjë ankim i depozituar nga ana e kandidatëve për shkelje të procedurës, referuar nenit 52 të Ligjit nr. 115/2016.

b) Procedura e ndjekur në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë

Nga dy raportet e publikuara nga Sekretari i Përgjithshëm, përkatësisht për vendet vakante në secilin Këshill, rezulton se është kryer procesi i verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për vendet vakante në secilin Këshill nga trupa e pedagogëve⁷⁶. Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit, pas depozitimit të listës së kandidatëve, në respektim të nenit 53, pika 2 dhe nenit 35 të ligjit nr.115/2016 ka filluar menjëherë punën për verifikimin e plotësimit të kushteve ligjore nga kandidatët. Më datë 03.10.2017, nëpërmjet shkresës nr. 2014/24, datë 03.10.2017, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit i ka përcjellë ONM-së kopje të dokumentacionit të administruar për çdo kandidat.

Gjatë verifikimit të plotësimit të kushteve nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është konkluduar se disa kandidatë kanë pasur mangësi në plotësimin e dokumentacionit provues të përmbushjes së kriterëve të parashikuara në nenin 36 të ligjit. Rezulton se Sekretari i Përgjithshëm ka kërkuar verifikimin e kandidaturave për të dy Këshillat, nga ana e organeve si Prokuroria e Përgjithshme, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Bujëve etj.

Nga procedura e verifikimit e realizuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit nga 7 kandidatët që garojnë për 2 vendet në KLGJ, ka rezultuar se vetëm 4 prej tyre plotësojnë kushtet ligjore të parashikuara në nenin 36, pika 2 të Ligjit nr. 115/2016.⁷⁷ Ndërkohë tre kandidatët e tjerë që nuk kanë plotësuar kushtet ligjore, janë si vijon:

⁷⁶ <http://www.droni.al/wp-content/uploads/2017/11/Raport-kandidatet-pedagoge-KLP.pdf>

<http://www.droni.al/wp-content/uploads/2017/11/Raport-kandidatet-pedagoge-KLGJ.pdf>

⁷⁷Këto kandidatë janë: Mirela Bogdani, Maksim Ooku, Erjon Muharremaj dhe Ilir Panda.

- Kandidatja znj. **Brunela Kullolli**, rezulton se nuk plotëson kriterin ligjor të parashikuar në nenin 36, pika 2, gërma ç) të ligjit të sipërcituar, pasi nuk është personel akademik i kategorisë “lektor”. Kjo kandidate e cila është përfshirë në garë vetëm si personel i IAL-ve, në momentin e vlerësimit ka qenë në fazën e marrjes së gradës shkencore “Doktor”, një gradë e cila është e lidhur detyrimisht me kategorinë “Lektor”.
- Kandidati znj. **Darjel Sila**, është konstatuar se nuk plotëson kriterin ligjor të parashikuar në pikën b) të dispozitës së sipërcituar, pasi nuk ka arritur të provojë përvojën e punës 15 vjeçare në profesionin e juristit, duke qenë se është diplomuar më 03.02.2004 pranë Universitetit të Athinës.
- Kandidatja znj. **Erjona Canaj**, është diplomuar në vitin 2005 në Universitetin “La Sapienza” Romë, e si rrjedhojë nuk përmbush kriterin ligjor të minimumit të përvojës si juriste prej 15 vitesh parashikuar në pikën b) të dispozitës së sipërcituar.

Pas verifikimit të kandidaturave që garojnë në KLP, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit ka përpiluar listën me 5 kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, përkatësisht: znj. **Mirela Bogdani**, znj. **Oriona Muçollari**, znj. **Eneida Sema**, z. **Sandër Beci** dhe z. **Gent Ibrahimi**. Siç është përmendur më herët, kandidatët z. **Darjel Sina** dhe znj. **Erjona Canaj**, të cilët rezultojnë të kenë kandiduar për të dy Këshillat nuk plotësojnë kushtet ligjore ndaj, edhe për KLP-në janë s’kualifikuar nga gara.

Për realizimin e pikëzimit për kandidatët për KLP dhe KLGJ, në respektim të nenit 35, pika 7, gërma “c: të ligjit nr.115/2016, Sekretari i Përgjithshëm është bazuar në procesin dhe praktikën e Mbledhjes së Posaçme. Pikëzimi për dy nën komponentë si: *cilësia e platformës dhe vizioni që paraqet kandidati dhe aftësitë e përfaqësimit në publik*, është i ndryshëm nga pikëzimi i realizuar nga Mbledhja e Posaçme. Në raportin e përpiluar nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm është referuar si problematikë **mungesa e informacionit nga mbledhja e posaçme për mënyrën e dhënies së pikëve për çdo nën komponent të meritave profesionale, meritave morale, meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale si dhe meritave të tjera**. Mbledhja e Posaçme rezulton të ketë vënë në dispozicion vetëm procesverbalin e mbledhjes së saj, ndërkohë që ky dokument dhe vendimmarrja e kësaj mbledhje nuk gjendet i publikuar në asnjë faqe zyrtare.

Në përfundim të vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, rezulton se pikëzimi i kandidatëve ka qenë i ndryshëm nga pikëzimi vlerësues i realizuar nga Mbledhja e Posaçme. Arsytet e ndryshimeve ndërmjet pikëzimeve kanë prekur kryesisht të tre kategoritë, me përjashtim të meritave morale, pasi kjo e fundit është një kategori e vlerësuar vetëm për kandidatin Gent Ibrahimi për shkak të ofrimit të kontributit të tij në reformën në drejtësi. Gjithashtu, cilësia e platformës, aftësitë e përfaqësimit në publik, mos prezenca gjatë seancës dëgjimore etj., kanë qenë disa nga arsyet përse kandidatët janë vlerësuar më me pak pikë në aspektin e meritave organizative, drejtuese dhe menaxheriale. Ndërkohë, përsa i përket meritave profesionale, një element ndikues në uljen e pikëve ka qenë moskryerja e veprimtarive dhe përvojave profesionale të lidhura me fushën e Këshillave.

Nr.	Kandidatët për Këshillin e Lartë të Prokurorisë	Pikët totale sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm	Pikët totale sipas vlerësimit të Mbledhjes së Posaçme
1	Gent Ibrahimi	94.17 pikë	90.47 pikë
2	Mirela Bogdani	85.95 pikë	86.95 pikë
3	Sandër Beci	77 pikë	82 pikë
4	Eneida Sema	65.95 pikë	66.95 pikë
5	Oriona Muçollari	57.2 pikë	56.2 pikë
6	Erjona Canaj	Nuk kualifikohet	68.2 pikë
7	Dariel Sina	Nuk kualifikohet	71.7 pikë

Nr.	Kandidatët për Këshillin e Lartë Gjyqësor	Pikët totale sipas vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm	Pikët totale sipas vlerësimit të Mbledhjes së Posaçme
1	Ilir Panda	88.27 pikë	84.95 pikë

2	Mirela Bogdani	80.7 pikë	82.7 pikë
3	Erjon Muharremaj	79 pikë	79 pikë
4	Erjona Canaj	Nuk kualifikohet	75.3 pikë
5	Maksim Ooku	74.34 pikë	73.34 pikë
6	Brunela Kullolli	Nuk kualifikohet	66.87 pikë
7	Dariel Sina	Nuk kualifikohet	65 pikë

Në përputhje me nenin 35, pika 7 të ligjit nr. 115/2016, Sekretari i Përgjithshëm ka hartuar listën me emrat e kandidatëve që plotësojnë kushtet e parashikuara nga Kushtetuta dhe ligji për të qenë anëtarë të KLGJ-së dhe KLP-së; lisëna me emrat e kandidatëve që nuk plotësojnë kushtet si dhe raportin ku vlerësohet shkalla e përmbushjes së kriterëve profesionale e morale nga secili kandidat i kualifikuar.

ONM ka realizuar verifikimet për kandidatët, bazuar në nenin 286 të ligjit nr. 115/2016. Raportet e verifikimit të kandidatëve nga ONM nuk janë bërë publike. Mgjth, një informacion i pjesshëm për vlerësimet e ONM-së është pasqyruar në raportin e vlerësimit të përpiluar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Sipas vlerësimit të ONM-së platformat e pjesës më të madhe të kandidatëve në KLGJ reflektojnë parime të përgjithshme, pa ndonjë vizion specifik. Përsa i përket vlerësimit të kriterit profesional për pjesën më të madhe të kandidatëve në KLGJ, ONM është shprehur se kontributi akademik/shkencor ose ka qenë mesatar ose nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk është dhënë ndonjë informacion i vlefshëm. Referuar vlerësimit të kriterit moral (integritetit) të kandidatëve në KLGJ, rezulton të jetë pasqyruar në raportin e vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm, vlerësimi i ONM-së për kandidatin, Z. Ilir Panda, për të cilin vërehet se *“Ka qenë i angazhuar politikisht në nivel shumë të lartë në të kaluarën”*.

Përsa i përket vlerësimit të kriterit profesional për kandidatët në KLP, vërehet se, ONM ka evidentuar se platformat e paraqitura nga shumica e kandidatëve konsistojnë më shumë në një letër motivuese, duke mos paraqitur ndonjë vizion specifik me objektiva që duhen përmbushur. Ndërkohë përsa i përket elementit të jetëshkrimit, vetëm për 2 nga kandidatët ONM është shprehur se profili i tyre akademik duket të jetë mbi mesataren. Nga vlerësimi i realizuar nga ONM, rezulton se kandidati Gent Ibrahim i nuk duket se plotëson kriterin e parashikuar në nenin 36, paragrafi 2, shkronja c) të ligjit nr. 115/2016, sipas të cilit veprimtaria pedagogjike me kohë të pjesshme duhet të ketë ndodhur secilin vit në 5 vite përpara kandidimit. Nga jetëshkrimi i paraqitur rezulton se nuk shihet veprimtari e tillë në periudhën kohore ndërmjet viteve 1998 dhe 2016. Për mos përmbushjen e këtij kriteri rezulton se kandidatja për në KLGJ, Znj. Kullolli është përjashtuar nga gara, situatë e cila sipas këtij Raporti ka gjeneruar në një procedurë diskriminimi. Por këtij pretendimi i është dhënë përgjigje nga ana e Këshillit Pedagogjik të Shkollës së Magjistraturës dhe verifikimit të dosjes së realizuar nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm. Sipas argumenteve të këtyre institucioneve, ligji nr. 115/2016 ka bërë një dallim të qartë ndërmjet ‘anëtarëve të personelit akademik’ të IAL-ve, të cilët sipas ligjit “Për arsimin e lartë” duhet të gëzojnë statusin e lektorit ose të profesorit, si dhe ‘pedagogëve jo magjistratë të Shkollës së Magjistraturës’.⁷⁸ Përsa i përket kriterit moral (integritetit) të kandidatëve në KLP, në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm nuk evidentohet asnjë vlerësim i ONM-së.

Procedura e ndjekur nga nënkomisioni i posaçëm parlamentar

Më datë 17.01.2018, dy raportet e Vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm përkatësisht për kandidatët që garojnë në KLP dhe kandidatët që garojnë në KLGJ i është përcjellë Komisionit të Ligjeve në Kuvend, i cili brenda afatit 3 ditor nga paraqitja e listës ka krijuar Nënkomisionin *Ad Hoc* për vlerësimin e mëtejshëm dhe përzgjedhjen e kandidatëve.

⁷⁸Faqe 12 e Raportit: <http://www.droni.al/wp-content/uploads/2017/11/Raport-kandidatet-pedagoge-KLP.pdf>